



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 10.02.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "PRISHTINA REA" për aktivitetin: "Sherbimet e konsulences në fushën e kultures-ritender" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5523-322 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Prishtina Rea" e datës 06.02.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sherbimet e konsulences në fushën e kultures-ritender" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5523-322, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 03.02.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 03.02.2020;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**PRISHTINA REA**" me datë 06.02.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sherbimet e konsulences në fushën e kultures-ritender" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5532-322.

Autoriteti Kontraktues, me datë 10.02.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se tenderuesi i propozuar për kontratë ka dorëzuar tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim nuk është i qëndrueshëm për faktin se në dosjen e njëjtte që ju e përmendni dhe pikën 18.1 ku është shënuar teksti Afati i fundit për dorëzim është 03.01.2020 është edhe pjesa e Fteses për tender në faqen 2 ku është shënuar Tenderet duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar deri me datën 03.01.2020 para orës 13:30. Sigurisht se ky tekst është në mos përputhje me tekstin nga pika 18.1, por deri në momentin e dorëzimit të tenderëve askush nga të interesuarit për pjesëmarrje e as ju nuk e keni kontestuar këtë mos përputhje. Duke u

bazuar ne kete rrjedh se per nje gabim teknik nuk mund te refuzohet e drejta per dorezim te tenderit deri ne kohen e cekur ne ftesen per tender,pasi qe gabimi eshte nga ana e Autoritetit Kontraktues e jo nga ana e tenderueseve.Bazuar ne kete eshte pranuar edhe tenderit i tenderuesit tjeter ne oren 13:23.

-Pretendimet tjera lidhur me vleresimin jo real te jurise poashtu nuk qendrojne pasi qe juria ka qene e perbere nga profesionistet e lemise se prokurimit dhe une nuk kam kompetence profesionale per refuzim te rekomandimeve te tyre.Lidhur me kete vetem mund te them se juria ka dhene nje konstatim te drejt lidhur me gabimet gjuhesore,pasi qe nuk mund te jete bartes i aktiviteve nje tenderues qe ka probleme drejtshkrimore.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

